

Parathënie

Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit rajonal dhe fqinjësisë së mirë, si kriter kyç që rrjedh nga procesi i Integrimit Evropian, Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi në fushën e përkthimit të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe si dhe bashkëpunimit në sferën e përafrimit të legjislacionit.

Marrëveshja e nënshkruar me datë 26 mars 2014, ndër të tjera parashikon themelimin e Komisionit Teknik që ka kompetencë përcaktimin dhe koordinimin e kalendarit vjetor të legjislacionit të BE-së që duhet të përkthehet në gjuhën shqipe, përcaktimin e procedurave të unifikuara të përkthimit dhe verifikimit të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe dhe certifikimin e versioneve përfundimtare të akteve të përkthyer në gjuhën shqipe.

Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në këtë fushë është unik dhe ka rezultuar i frytshëm, ku ndër të tjera veçojmë përpilimin e manualit për përkthimin e legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe si dhe databazën për publikimin e akteve ligjore të përkthyer.

Jemi të vetëdijshëm se përkthimi i *acquis* përfshin koordinim efektiv të shumë strukturave brenda administratës publike dhe jashtë saj si dhe angazhim të pandërprerë të palëve të përfshira në këtë proces. Për këtë arsye Komisioni i sipërpërmendur konceptoi dhe realizoi këtë projekt të rëndësishëm, me synim të vetëm avancimin e procesit të përkthimit të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe.

Realizimi i këtij manuali u mundësua nga koordinimi efikas i anëtarëve të Komisionit Teknik i të dyja vendeve, Ministria e Integrimit Evropian (RKS) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (RSH). Përveç autorit, kontribues në zhvillimin e këtij manuali janë anëtarët e Komisionit Teknik që kanë shërbyer nga viti 2016 e tutje. Puna e tyre dhe përkushtimi maksimal, që nga përpilimi i konceptit e deri tek rishikimi i materialit të përpiluar janë reflektim i përgatitjes dhe koordinimit profesional të këtyre anëtarëve.

Një falënderim i veçantë shkon për projektin e GIZ-it “Mbështetje për Procesin e Integrimit Evropian në Kosovë”, të cilët mbështetën projekt-propozimet e Komisionit dhe mundësuan realizimin e manualit.

Përmbajtja

HYRJE	IV
I. PARIME E RREGULLA TË PËRGJITHSHME	2
I.1 Parime për përkthimin e <i>Acquis</i>	2
I.2 Kërkesat për gjuhën dhe stilin e teksteve në gjuhën shqipe	7
II. LLOJI I DOKUMENTEVE	12
II.1 Rregulloret	12
II.2 Direktivat	12
II.3 Vendimet	13
II.4 Rekomandimet	13
II.5 Akte të tjera	13
III. DATA NË DOKUMENTE	15
IV. LËNDA E DOKUMENTIT	16
V. PLOTËSUES INFORMATIVË	21
VI. EMËRTIMI I INSTITUCIONIT QË LËSHON AKTIN	22
VII. ZGJIDHJA JURIDIKE	24
VII.1 Përbërja eventuale e Këshillit	24
VII.2 Heqja dorë nga legjislacioni parësor.....	24
VII.3 Udhëzimi përfundimtar për legjislacionin dytësor	24
VII.4 Udhëzim për procesin përgatitor	24
VIII. ARGUMENTIMI	27
VIII.1 Sistemi i vjetër (për rregullat e botuara deri më 31 maj 1999).....	27
VIII.2 Sistemi i ri (për rregullat e publikuara nga 1 qershori 1999)	27
VIII.3 Përjashtim	27
VIII.4 Neke standardne stavke obrazložnja	28
IX. FORMULA E PRANUAR	30
IX.1 Ndarja e tekstit	30
IX.2. Emërtimi i dispozitave	32

IX.3 Procedurat për zgjedhjen dhe analizimin e proceseve	33
IX.4 Procedurat për dokumentacionin e organizatave të përbashkëta të tregut (bujqësisë)	41
IX.5 Ndryshimet e objektivave	44
IX.6 .Udhëzime	51
IX.7 Përlllogaritjet dhe përcaktimet	56
IX.8 Dispozita përfundimtare	58
IX.9 Datimi dhe nënshkrimi	69
X. DISA TERMINOLOGJI TË PËRGJITHSHME	71
X.1. Emërtimi i dokumenteve bazë	71
X.2. Emërtimi i disa publikimeve	73
X.3. Emërtimi i shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (dhe renditja e tyre)	73
X.4. Emërtimi i gjuhëve zyrtare të shteteve evropiane (dhe renditja e tyre)	74
X.6. Njësitë monetare.....	75
X.7. Kuptimi i shprehjeve latine në gjuhën shqipe	75
X.8. Të ndryshme.....	76
<i>Shtojcë 1</i>	78
<i>Shtojcë 2</i>	83

HYRJE

Përkthimi, lekturimi dhe redaktimi i akteve primare dhe sekondare të legjislacionit të Bashkimit Evropian është një detyrë që del gjatë procesit të anëtarësimit në BE. Në fillim të punës për përkthimin dhe për përpunimin e teksteve të përkthyer është vlerësuar e domosdoshme të përgatitet një doracak, i cili do t'u mundësojë përkthyesve, redaktorëve dhe profesionistëve të tjerë, të përfshirë në përkthimin dhe në harmonizimin terminologjik të legjislacionit të BE-së, të kenë udhëzime për t'i zgjidhur problemet me të cilat ballafaqohen gjatë procesit të përkthimit. Idetë për hartimin e një doracaku të tillë kanë rrjedhur nga përvojat me përkthimin e legjislacionit të BE-së në vende të ndryshme që kanë kaluar nëpër procesin e anëtarësimit. Doracaku për përkthimin e dokumenteve ligjore të BE-së është rezultat i këtyre përvojave. Ky dokument mund të quhet një dokument dinamik, i cili në të ardhmen mund të ndryshohet e plotësohet, por duke u ruajtur qëllimi dhe objekti i tij parësor që është ndihma për përkthyesit dhe bashkëpunëtorët e tjerë, të cilët janë të përfshirë në përkthimin e legjislacionit të BE-së, për të ruajtur cilësinë dhe për të arritur një shkallë sa më të lartë të njëjtësisë kuptimore të dokumenteve të përkthyer.

Në fillim të doracakut janë parashtruar udhëzimet përkatëse që e përshkruajnë rëndësinë e përkthimit të legjislacionit të BE-së dhe i identifikojnë vështirësitë dhe problemet më të mëdha që hasen gjatë përkthimit. Gjithashtu, theksohet se gjatë përkthimit të akteve ligjore të BE-së është me rëndësi që dokumentet e përkthyer ta ruajnë kuptimin dhe frymën e plotë të teksteve burimore, duke u ruajtur po ashtu konsistenca terminologjike. Për më shumë, këto udhëzime japin sqarimet e duhura se si të veprohet në rastet kur ka mospërputhje gjuhësore e drejtshkrimore midis tekstit në gjuhën burimore dhe tekstit të përkthyer.

Është me rëndësi të theksohet qysh në fillim se përkthimi i *acquis* në gjuhën shqipe ka disa qëllime e funksione kryesore:

- E para, përbën kusht të domosdoshëm për anëtarësim në BE;
- E dyta, ndihmon procesin e përafrimit dhe të njëjtësisë të legjislacionit vendas me *acquis*;
- E treta, garanton përqsje sa më të përafërt kuptimore midis tekstit të *acquis* me tekstin në gjuhën vendëse.

Përkthimi i *acquis* kërkon një punë shumëvjeçare, gjatë së cilës procesi i përkthimit duhet të ecë paralelisht me atë të përafrimit dhe të njëjtësisë të legjislacionit. Ky proces i përkthimit duhet të kuptohet si shqipërim i *acquis* dhe si përshtatje e sistemit ligjor e institucional vendës me filozofinë mbi të cilën mbështetet BE-ja dhe aktet e saj ligjore.

Procesi i përkthimit duhet të shoqërohet me krijimin e një baze të dhënash, modeleve të akteve të BE-së, fjalorëve terminologjikë për fusha prioritare, si tregu i brendshëm, doganat dhe tregtia, bankat, shërbimet financiare, bujqësia, transporti

etj. Kjo veprimtari konsiderohet e rëndësishme, jo vetëm për shkak të përdorimit nga përkthyesit vendës, por edhe për t'u shkëmbyer me trevat shqipfolëse, pasi do të ndihmonin në njëjtësimin terminologjik të akteve ligjore të BE-së në gjuhën shqipe. Duke qenë se gjuha shqipe dhe drejtshkrimi i saj gjejnë zbatim të njëjtë në hapësira të ndryshme administrative e politike në të cilat flitet shqipja, është e pashmangshme që edhe nëpërmjet këtij doracaku të synohet njëjtësimi i teksteve dhe i terminologjisë në gjuhën shqipe për të gjitha këto hapësira shqipfolëse, pavarësisht nga specifikat e tyre.

Duke pasur për qëllim përgatitjen e kësaj baze të nevojshme metodologjike dhe terminologjike, Ministria e Integrimit Evropian në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, në bashkëpunim me GIZ-in (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) kanë përgatitur Doracakun për Përkthimin e Legjislacionit të BE-së që bashkë me botimet e tjera të saj të mund t'i shërbejnë sa më mirë këtij qëllimi.

Ky botim është mbështetur në rekomandimet përkatëse për përkthimin e Akteve të Këshillit të BE-së në gjuhën amtare të shteteve anëtare të BE-së, si dhe në doracakët e tjerë të hartuar në vendet e rajonit që kanë qenë ose janë pjesë e procesit integruar në BE. Në këtë kuptim, për shkak të specifikave të gjuhës shqipe dhe të rregullave përkatëse të drejtshkrimit të saj, ka qenë e detyrueshme që ky botim t'i marrë parasysh rekomandimet gjuhësore dhe të mbështetet po ashtu edhe në Manualin për Përkthimin e Legjislacionit të BE-së, të botuar nga Ministria e Integrimit Evropian e Republikës së Shqipërisë në prill 2006, në Tiranë.

Natyrisht, ky botim nuk synon të jetë i përsosur dhe ta mbulojë tërë gamën metodologjike të nevojshme për procesin e përkthimit të *acquis* në gjuhën shqipe. Sigurisht që botimi duhet të pasohet me botime të tjera, të cilat do të reflektojnë përfshirjen më të madhe të palëve të interesuara dhe përvojën e akumuluar në hapat e ndërmarrë gjatë këtij procesi të gjatë dhe voluminoz. Megjithatë, ky doracak është një pikënisje e mirë dhe paraqet një ndihmë për të gjithë ata që do të jenë të përfshirë në procesin e mundimshëm të përkthimit të legjislacionit të BE-së. Ky proces padyshim që do të jetë ndërveprues dhe të gjitha vërejtjet dhe komentet që do të dalin nga ky proces duhet të merren parasysh dhe të përfshihen në botimet e tjera eventuale të këtij doracaku.

I. PARIME E RREGULLA TË PËRGJITHSHME

I.1 Parime për përkthimin e *Acquis*

Njëra prej kërkesave për anëtarësimin në BE është edhe përkthimi i *acquis*, apo i tërësisë së legjislacionit të BE-së në fuqi. Natyrisht, kjo është një detyrë e vështirë jo vetëm për shkak të vëllimit të madh të teksteve që duhen përkthyer, por edhe për shkak se të gjitha përkthimet duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe të garantojnë mbështetje ligjore. Gjatë këtij procesi, janë disa rregulla të cilave përkthyesit duhet t'u përmbahen. Prandaj, qëllimi i këtij dokumenti është që përkthyesit në gjuhën shqipe të njihen me disa rregulla themelore që duhet të zbatohen me rastin e përkthimit të legjislacionit të BE-së.

Legjislacioni i BE-së mbizotëron ligjet vendore që janë zhvilluar deri në atë shkallë sa mund të konsiderohen si grup ligjesh të ndryshme dhe të pavarura me sistemin e tyre konceptual dhe me terma ekuivalentë në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së. Në këtë kuadër, kërkohet që përkthyesit të kenë njohuri të caktuara lidhur me BE-në, me institucionet dhe me ligjet e saj.

Duhet theksuar se të gjitha tekstet ligjore të BE-së shkruhen dhe publikohen në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së dhe të gjitha variantet në gjuhët zyrtare janë të fuqizuara ligjërisht dhe janë autentike në mënyrë të barabartë. Nga pikëpamja ligjore, të gjitha tekstet në këto gjuhë zyrtare konsiderohen si tekste origjinale e jo si përkthime. Parimi i autenticitetit të barabartë është me rëndësi të jashtëzakonshme, sepse nënkupton se secili tekst në gjuhët përkatëse është i barabartë për interpretim ligjor nga gjyqet, ndërkohë që asnjëri tekst nuk konsiderohet mbizotërues në rast të dykuptimisë apo ndryshueshmërisë tekstore midis versioneve në gjuhë të ndryshme.

Përkthimet cilësore mund t'i përmbushin kërkesat e cilësisë dhe të saktësisë vetëm nëse përmbushin kriteret e ekuivalencës, të besueshmërisë dhe të transparencës së tekstit burimor me tekstin e synuar të gjuhës që përkthehet.

I.1.1 Prodhimi i tekstit dhe besueshmëria

Në çdo përkthim, njëri nga vendimet më të rëndësishme që duhet të marrë përkthyesi është ai nëse teksti i synuar duhet jetë i orientuar drejt gjuhës burimore apo gjuhës së synuar dhe deri në çfarë shkalle. Sa u përket teksteve legjislative, më parë është menduar se mbështetja ligjore do të mund të arrihej vetëm nëpërmjet përkthimit fjalë për fjalë. Por, efekti mund të jetë krejtësisht i kundërt. Përkthimet fjalë për fjalë shpeshherë prodhojnë tekste që janë pjesërisht apo krejtësisht të pakuptueshme, duke e bërë të domosdoshme nevojën për ta konsultuar tekstin burimor. Prandaj, sikurse në të gjitha rastet e përkthimeve, përkthimet e legjislacionit të BE-së janë të orientuara drejt lexuesit. Përkthimet autentike janë ligje në fuqi që zbatohen nga gjyqet dhe nga autoritetet e tjera të BE-së që janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të BE-së. Për më tepër, legjislacioni i BE-së përkthehet në të gjitha gjuhët zyrtare, me qëllim që të gjithë qytetarët e BE-së të kenë qasje në të. Kjo qasje mbështetet në parimin e barazisë para ligjit, si dhe në parimin se ata që janë të prekur nga ligji duhet të jenë në gjendje ta lexojnë atë.

Duke qenë se përkthimi që mbështetet krejtësisht në tekstin burimor mund të rezultojë i pakuptimtë apo i paqartë, atëherë me rastin e përkthimit të legjislacionit të BE-së vëmendja duhet t'i kushtohet gjuhës së synuar. Çdo qasje tjetër mund të paraqesë rrezik në rastet kur kërkohet interpretimi ligjor dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së. Për këtë arsye është me rëndësi që teksti i prodhuar në gjuhën shqipe ta ruajë frymën dhe natyrën e gjuhës shqipe dhe prandaj është me rëndësi që teksti final të duket sikur të jetë shkruar në gjuhën shqipe që në fillim të hartimit të tij.

Nga ana tjetër, është me rëndësi të theksohet se përkthyesit nuk duhet ta kenë përshtypjen se janë të autorizuar të hartojnë një tekst të ri të një ligji të BE-së. Sikurse edhe hartuesit e legjislacionit të BE-së, edhe ata duhet të jenë të vetëdijshëm që kanë kufizime të caktuara.

Para së gjithash, tekstet legjislative të BE-së cilësohen me shkallë të lartë të standardizimit. Për shkak të njëformësisë, struktura formale e akteve të BE-së është e njëjtë në secilën gjuhë zyrtare. Frazat dhe fjalitë e tëra që shprehin veprime ligjore të përsëritshme janë të standardizuara në të gjitha gjuhët. Me qëllim të ruajtjes së formave të standardizuara, janë përgatitur doracakët përkatës që duhet të ndiqen gjatë përkthimit. Udhëzimet e tilla duhet të ndiqen gjatë përkthimit të akteve të vendosura nga Këshilli i Evropës, siç janë: rregulloret, direktivat, vendimet, rekomandimet, rezolutat, mendimet, deklaratat, deklarimet, marrëveshjet etj. Prandaj, u kërkohet përkthyesve t'u përmbahen standardeve për secilin lloj të aktit të BE-së, duke e ruajtur njëformësinë e tyre.

Forma standarde dikton strukturën dhe tiparet përbërëse të një akti të veçantë. P.sh., pjesët kryesore të një rregulloreje janë: titulli, parathënia (citimet, recitimet, formula e aktvendimit, termat e miratimit, i adresuari, vendi, data dhe nënshkrimi). Për më tepër, forma standarde përshkruan faqosjen, duke përfshirë hapësirën e tekstit, paragrafët, shenjat e pikësimit, madje edhe karakteristikat shkrimore, siç janë përdorimi i shkronjave të mëdha, shkronjat e zakonshme, shkronjat e zeza (bold) dhe ato italike. Standardizimi shkon deri në atë masë sa që përcakton se si të shkruhen njësitë matëse, njësitë monetare, data dhe koha, si dhe si të përdoren shenjat e citimit, numrat dhe shkronjat në njësitë numerike, si të citohen aktet e ndryshme të BE-së, referencat në revista zyrtare etj.

1.1.2 Terminologjia

Terminologjia ligjore e BE-së i ka vështirësitë e veta. Kjo ndodh për arsye se janë krijuar neologjizma të shumtë për t'i përkufizuar konceptet e reja të legjislacionit të BE-së. Për këtë arsye janë bërë përpjekje të shumta që të shmanget përdorimi i termave ekzistues të sistemeve ligjore kombëtare, posaçërisht i termave teknikë, me qëllim që termat ligjorë të BE-së të mos interpretohen me kuptim të termave të sistemeve ligjore kombëtare të vendeve anëtare. Kriteri kryesor që është përdorur për krijimin e termave ligjorë të BE-së ka qenë transparenca dhe përthyeshmëria e tyre. Sa herë që është e mundur krijohen "ndërkombëtarizma", kuptimi i të cilëve njihet lehtë dhe mund të përkthehen lehtësisht në të gjitha gjuhët. Sa u përket neologjizmave, ato krijohen në dy mënyra: duke ia shtuar një kuptim të ri termit ekzistues, posaçërisht fjalëve të zakonshme (*regulation* – *rregullore*, *directive* –

direktivë, decision – vendim), apo duke krijuar terma të rinj që përkthehen pastaj duke kaluar nëpër disa procedura përkthimi. Termat më të shpeshtë ekuivalentë të përkthyer janë:

- ekuivalentët e plotë (*common market – tregu i përbashkët, co-decision procedure – procedurat e bashkëvendimmarrjes, direct applicability of European law – zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e legjislacionit të BE-së*);
- natyralizimi (*comitology – komitologjia, derogation – heqja*);
- huazimet (*Ombudsman – ombudsmeni, euro – euro*) dhe
- ekuivalentët (*acquis – acquis*).

Problemi tjetër që paraqitet me rastin e përkthimeve është përdorimi i akronimeve dhe i shkurtesave të shumta. Në këtë pikë disa akronime mund të huazohen, disa të tjera të përkthehen dhe të përdoren siç përdoren në gjuhën shqipe, por është me rëndësi të ketë njëjtësi në përdorim. Sugjerimet për përdorimin e shkurtesave janë dhënë në kapitullin përkatës.

Përkthyesit janë të detyruar ta përdorin terminologjinë zyrtare pavarësisht se a pajtohen me të ose jo. Konsistenca terminologjike është parim i detyrueshëm në përkthimet ligjore dhe është me rëndësi të jashtëzakonshme me qëllim që të sigurohet mbështetshmëria ligjore. Për këtë arsye, përkthyesit janë të detyruar t'i përdorin termat e njëjtë në gjuhën shqipe sa herë që përkthejnë një koncept të veçantë kur shfaqen në kontekst të legjislacionit të BE-së. Përveç këtij doracakut, përkthyesit duhet të konsultojnë fjalorë të ndryshëm që përmbajnë terminologjinë ligjore të BE-së (Eurovac, Fjalori i Termave Ligjorë të BE-së, Fjalori i Termave Financiarë, Fjalori i Termave të Ekonomisë etj.), si dhe dokumentet e tjera normative të shqipes që do t'i përmendim më poshtë.

Duke qenë se korpusi i termave ligjorë të BE-së në gjuhën shqipe është ende mjaft i kufizuar, në disa raste të kufizuara përkthyesit mund të jenë të detyruar të sajojnë terma ekuivalentë në gjuhën shqipe. Në raste të tilla, është e këshillueshme që të përgatitet një listë me terma të tillë dhe të dorëzohet bashkë me dokumentin e përkthyer.

I.1.3 Përdorimi i anglishtes si gjuhë burimore

Sa i përket gjuhës kryesore burimore prej të cilës do të përkthehen tekstet në gjuhën shqipe, anglishtja është përzgjedhur si gjuhë themelore burimore e teksteve, për shkak se është gjuhë me shtrirjen dhe me përdorimin më të madh në Kosovë. Edhe pse të gjitha versionet gjuhësore të legjislacionit të BE-së janë njëloj autentike, përkthyesit duhet të jenë të vetëdijshëm se anglishtja nuk u bë gjuhë zyrtare deri në vitin 1973 (15 vjet pas katër gjuhëve të para zyrtare). Madje edhe atëherë, frëngjishtja ishte gjuhë dominuese me rreth 80 për qind pjesëmarrjeje në të gjitha aktet e Komunitetit, të hartuara fillimisht në atë gjuhë deri në vitin 1990. Kjo situatë zgjati deri në fund të viteve 1990 dhe pastaj zhvillimet filluan të shkojnë në drejtime të tjera, duke favorizuar gjuhën angleze dhe duke e bërë atë *lingua franca* jo vetëm në BE, por edhe në institucionet e tjera ndërkombëtare. Ky zhvillim është me rëndësi të merret parasysh, sepse do të thotë se, në shumicën e rasteve, në të

vërtetë "origjinalet" e akteve të BE-së janë hartuar në frëngjisht, ndërsa tekstet në anglisht janë përkthime. Sikur edhe në gjuhët e tjera të BE-së, shumica e termave në gjuhën angleze janë përkthyer nga frëngjishtja. Po ashtu, ndonjëherë termat në gjuhën frënge kanë qenë plotësisht ose pjesërisht të ruajtur (*acquis communautaire(acquis)*, Advocate – General), ose kanë ndikuar fuqishëm në përkthimin në gjuhën angleze (*democratic deficit* në vend të *democratic gap*, *deficit demokratik* në vend të *boshllëk demokratik*). Kjo ndonjëherë mund të shkaktojë probleme nëse termat në gjuhën shqipe krijohen duke u mbështetur vetëm në termat e anglishtes.

Për përkthyesit e shqipes, të një rëndësie të veçantë janë problemet e mundshme të interferencës ndërmjet anglishtes dhe shqipes në lidhje me gjuhën (terminologjinë, sintaksën), stilin dhe teknikat e hartimit. Përkthyesit e kualifikuar zakonisht janë të vetëdijshëm për kurthet e interferencës terminologjike. Përkthyesit gjithashtu duhet të kenë kujdes që të mos sajojnë fjali të panatyrshme në gjuhën shqipe sipas modelit të sintaksës së anglishtes. Për më shumë, duhet pasur parasysh se anglishtja dhe shqipja nuk janë gjuhë me strukturë të njëjtë dhe aty ku anglishtja përdor nyja dhe parafralë për të ndërtuar fleksionin përkatës, shqipja i ka mbaresat e saj. E njëjta gjë vlen sa i përket stilit të shkrimit. Mbase gabimi më i zakonshëm dhe më serioz që mund të bëhet gjatë përkthimeve ligjore është përkthimi i urdhëresave ligjore *shall* me kohën e ardhme të foljeve në gjuhën shqipe, gjë që automatikisht ndryshon efektin e synuar ligjor (p.sh.: *The objectives of the Union shall be achieved as provided in this Treaty* – objektivat e Unionit arrihen siç parashihet në këtë Traktat dhe jo: objektivat e Unionit do të arrihen siç parashihet në këtë Traktat).

I.1.4 Shmangia e interpretimeve ligjore subjektive

Përkthyesit duhet ta kuptojnë tekstin burimor, por jo ta interpretojnë atë në kuptimin juridik. Interpretimi juridik është detyrë e gjyqtarëve dhe e juristëve të tjerë përgjegjës për zbatimin e ligjit. Në këtë kuptim, detyra e përkthyesve është ta shprehin atë që është shkruar dhe është thënë në tekstin burimor dhe jo të shprehet çfarë mendojnë ata se do të duhej të thuhej në një tekst. Përkthyesit duhet t'i kenë të zhvilluara jo vetëm aftësitë e gjuhës, por njëkohësisht t'i dinë edhe teknikat e shkrimit për ta kuptuar tekstin dhe për t'i njohur efektet e synuara ligjore të shprehura nëpërmjet një teksti ligjor. Kudo që teksti burimor në gjuhën angleze është i paqartë ose i dykuptimtë, përkthyesit janë të detyruar t'i shohin një ose më shumë tekste të tjera autentike, mundësisht tekstin në gjuhën frënge. Në të vërtetë, mund të thuhet se përkthyesit duhet të shohin gjithmonë një ose më shumë variante të tjera të teksteve në gjuhët e tjera zyrtare, sidomos kur teksti burimor në gjuhën angleze është një përkthim i mëvonshëm i bërë dhe i vërtetuar pas miratimit të teksteve origjinale. Qasja shumëgjuhëshe, pra duke përdorur dy ose më shumë tekste burimore, është padyshim mënyra më e mirë për të siguruar cilësi të lartë dhe besueshmëri ligjore, edhe pse merr më tepër kohë. Prandaj, kjo qasje varet kryesisht nga rëndësia e një akti të veçantë. Në çdo rast, përkthyesit duhet të shënojnë ndonjë paqartësi apo dykuptimësi në tekstin në gjuhën angleze dhe të njëjtën t'ua referojnë si çështje redaktorëve gjuhësorë dhe ekspertëve ligjorë,

edhe në qoftë se kanë gjetur përkthimin pas konsultimit me variantet e tjera gjuhësore.

Përkthyesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm se janë përgjegjës për saktësinë e përkthimit. Ndonëse teksti burimor duhet të jetë i përkthyer tërësisht, saktësia nuk arrihet duke riprodhuar apo duke përkthyer fjalë për fjalë të gjitha fjalët e tekstit burimor. Sikurse shkruarit e tekstit, edhe përkthyesit duhet të përpiqen t'i përmbahen qartësisë dhe përpikërisë, edhe nëse kjo kërkon lënien jashtë të një fjale të panevojshme që shfaqet në tekstin burimor. Duhet pasur kujdes që lënia jashtë e fjalëve të tilla është e lejuar për aq sa nuk ka ndikim në kuptim dhe nuk ndryshon asgjë, si dhe vetëm në dispozitat jo të standardizuara. Është jashtëzakonisht me rëndësi që përkthyesi të jetë i vetëdijshëm deri në ç'skallë mund ta ushtrojë lirinë në përkthim dhe njëkohësisht ky vetëdijesim është çelës për vendimmarrje të përgjegjshme. Ndër të tjera, kjo nënkupton që përkthyesit janë në gjendje të bëjnë dallimin midis dispozitave të standardizuara dhe jo të standardizuara.

I.1.5 Formësimi i rregullave ligjore

Kushtet e aktgjykimit që përbëjnë pjesën më të rëndësishme të akteve të BE-së përbëhen nga një numër dispozitash të standardizuara dhe jo të standardizuara. Përkthyesit janë të detyruar që t'i përdorin format përkatëse standarde kur përkthejnë dispozita të standardizuara (dispozitat procedurale, masa zbatuese, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare), ndërsa dispozitat jo të standardizuara duhet të përkthehen sipas natyrës së gjuhës shqipe dhe, për aq sa është mundshme, në përputhje me praktikën shkrimore të shqipes. Këto janë dispozitat që identifikojnë lëndën, përcaktojnë fushëveprimin e aktit, përcaktojnë përkufizimet dhe përshkruajnë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Aktualisht, nuk ka udhëzime për hartimin dhe për formulimin e këtyre dispozitave në gjuhën shqipe.

Dispozitat më të rëndësishme synojnë t'i përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve në formë të urdhrave ligjorë, ndalesave, lejeve dhe autorizimeve. Meqenëse rregullat ligjore janë formuluar në mënyrë të ndryshme në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, përkthyesit që ndjekin tekstin e anglishtes në mënyrë të drejtpërdrejtë ballafaqohen me rrezikun e ndryshimit të efekteve të dëshiruara ligjore me rastin e përkthimit në gjuhën shqipe. Për të garantuar besueshmërinë ligjore, përkthyesit duhet të kuptojnë se si veprojnë rregullat ligjore, të jenë në gjendje t'i identifikojnë elementet përbërëse të rregullave ligjore dhe të kenë aftësi të caktuara shkrimore për formulimin e rregullave ligjore në gjuhën shqipe. Kjo përfshin aftësinë që t'i përdorin modelet e duhura sintaksore me qëllim që të shprehen lidhjet e synuara logjike dhe të zgjedhin modelet e sakta dhe shprehje të tjera verbale për të formuluar performative ligjore. Mund të mendohet se kjo është detyrë e ekspertëve ligjorë, por në një fazë aq të vonë të përkthimit nuk mund të pritët që ekspertët ligjorë të bëjnë rishtas përkthimin e tërë tekstit apo edhe të kushteve më të rëndësishme të aktgjykimit. Prandaj, përkthyesit inkurajohen t'i përgjigjen kësaj sfide duke fituar aftësi për hartimin e rregullave ligjore në gjuhën shqipe dhe duke i diskutuar ato me ekspertë të tjerë të çështjeve gjuhësore e juridike.

I.1.6 Rishikimi përfundimtar i tekstit nga përkthyesit

Kontrollimi përfundimtar i tekstit nga përkthyesi është i dobishëm për t'u siguruar se përkthimi është i cilësisë së lartë dhe është ligjërish i besueshëm. Përkthyesi duhet ta krahasojë tekstin burimor me tekstin e synuar për të verifikuar saktësinë e përkthimit, duke konfirmuar se teksti i përkthyer ka barasvlerë kuptimore me tekstin burimor dhe prodhon efektet e dëshiruara ligjore. Është me rëndësi që përkthyesi t'u kushtojë vëmendje detajeve, posaçërisht shmangieve të mundshme që mund ta ndryshojnë efektin ligjor, siç mund të jetë përdorimi i lidhëzës "dhe" në vend të "ose" (apo anasjelltas) në një sërë rastesh. Për më shumë, përkthyesi duhet t'i rishikojë të gjitha citatat. Kur përkthehen citatat nga traktatet apo aktet e tjera të BE-së, përkthyesit duhet të përmendin përkthimin autentik fjalë për fjalë dhe të përmbahen nga rishikimi i tij edhe në qoftë se ka gabime. Për hir të ruajtjes së konsistencës, nuk ka përjashtime që janë të lejuara. Meqë përkthimet e akteve ligjore të BE-së në gjuhën shqipe nuk do të jenë të vërtetuara deri kur Shqipëria/Kosova të hyjë në BE, është shumë e rëndësishme të prodhohen variante ligjërish të miratuara të traktateve në gjuhën shqipe dhe të lihen ato në dispozicion të përkthyesve. Këto përkthime, si dhe termat në gjuhën shqipe të përdorur në këto tekste, do të njihen si zyrtare dhe do të jenë të detyrueshme për përkthyesit.

Rishikimi përfundimtar i tekstit duhet të përfshijë një kontrollim të thukët të terminologjisë për të siguruar që të gjithë termat ligjorë janë përdorur me konsistencë dhe në mënyrë korrekte. Po ashtu, duhet të rishikohen fjalët dhe frazat e veçanta që kanë mundur të paraqesin vështirësi me rastin e përkthimit. Nuk ka sinonime që janë të lejuara, pasi ato mund të keqinterpretohen me lehtësi. Për më tepër, termat në gjuhën shqipe dhe frazat në formulimet ligjore dhe në shprehje të tjera të standardizuara duhet të përdoren siç duhet. Njëkohësisht, struktura formale e tekstit duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e hartimit të BE-së. Çdo mangësi në këtë drejtim mund të ndikojë në vlefshmërinë e tekstit në gjuhën shqipe. Së fundi, kontrollimi përfundimtar shërben si një provë e cilësisë së përkthimit, në veçanti nëse teksti është i qartë, i shkruar në shqipen standarde dhe që lexohet sikur të ishte hartuar fillimisht në gjuhën shqipe. Në të gjitha rastet kur përkthyesi ka dyshime të caktuara, ai duhet ta përgatitë një listë pyetjesh për redaktorët gjuhësorë dhe për ekspertët ligjorë. Edhe pse të tre pjesëmarrësit kryesorë (përkthyesi, redaktori gjuhësor, eksperti ligjor) punojnë veç e veç në procedurën e përkthimit, rezultatet më të mira arrihen kur ka ndërveprim ndërmjet tyre. Teksti i përkthyer në këtë mënyrë i ka të gjitha parakushtet që të ketë vërtetësinë e duhur ligjore.

I.2 Kërkesat për gjuhën dhe stilin e teksteve në gjuhën shqipe

I.2.1 Disa udhëzime gjuhësore

Funksionet dhe mundësitë e saj shprehëse gjuha i realizon nëpërmjet stileve të ndryshme funksionale, të cilat përvijohen gjatë përdorimit të gjuhës. Ligjërimi i ligjeve është një stil i veçantë, tërësia e të cilit, me rregullsinë e vet të detyrueshme,

sendërton të ashtuquajturin “stil juridik”. Në rastin konkret, duke qenë se bëhet fjalë për përkthimin në gjuhën shqipe të një legjislacioni të përbashkët, siç është *acquis*, ky korpus përcaktohet më së pari nga standardet e vendosura unanimisht në gjuhët origjinale prej nga kryhet përkthimi, pra nga kërkesat themelore të parashtruara për përkthimin e rregullave juridike. Por, përpos besnikërisë ndaj originalit dhe njëjtësisë terminologjike, përkthyesit duhet të kenë gjithnjë parasysh edhe tiparet gjuhësore të gjuhës amtare, pra kuptueshmërinë që përcakton modeli gjuhësor i shqipes. Sa i përket zgjedhjes së terminologjisë së duhur, siç u tha më sipër, është e nevojshme që në rrethanat në të cilat terminologjia ligjore në gjuhën shqipe, sidomos ajo e ndërlidhur me legjislacionin e BE-së, ende nuk është konsoliduar sa duhet, grupi i punës i ngarkuar me këtë detyrë duhet të kryejë një rivlerësim të përdorimeve terminologjike në gjuhën shqipe gjatë këtyre viteve. Aty ku këta terma rezultojnë të shpeshtë dhe të ngulitur si duhet, si dhe në përputhje me kërkesat evropiane, çështja rezulton e zgjidhur vetiu. Përkundrazi, aty ku ka diversitet në këto përdorime terminologjike dhe kur mungon rregullsia në përdorimin e tyre, duhet parë cili është përdorimi më i shpeshtë. Nëse edhe ky rivlerësim nuk e lehtëson punën, atëherë, në kushtet e një përcaktimi *ex novo* të terminologjisë, mund të rezultojë më i frytshëm hulumtimi në tekstet e mëhershme juridike, të cilat mund të ofrojnë një zgjidhje të mbështetur në përdorimet juridike tradicionale të shqipes, por që janë ngulitur në aktet apo dokumentet juridike të periudhave të mëhershme në gjuhën shqipe, të cilat shpesh sot sillen për rishqyrtim.

1.2.2 Kriteret themelore të tekstit në gjuhën shqipe

Në fillim është me rëndësi që përkthyesi ta ketë të qartë që një përkthim nuk nënkupton vetëm zëvendësimin e një teksti në gjuhën burimore me një tekst tjetër në gjuhën e synuar. Teksti i përkthyer duhet ta ruajë barasvlerën kuptimore me tekstin burimor. Teksti i përkthyer komunikon një mesazh të caktuar. Duke u nisur nga ky konstatim, duhet të merret parasysh që varianti i një akti ligjor të BE-së në gjuhën shqipe të reflektojë plotësisht pamjen, respektivisht formatin e varianteve të teksteve në gjuhët zyrtare të BE-së. Është me rëndësi që teksti i përkthyer në gjuhën shqipe të ketë numrin e njëjtë të njësive (neneve, paragrafëve etj.) të tekstit burimor në mënyrë që pastaj të jetë i mundur referimi në një njësi të caktuar.

Teksti i përkthyer në gjuhën shqipe duhet patjetër t’i plotësojë disa kriteret kuptimore, formale e tekstore. Së këndejmi, në përkthimin e tekstit në gjuhën shqipe, kriteret bazë që duhet të merren parasysh janë:

- Kuptueshmëria dhe saktësia, përkthimi i gjithçkaje të rëndësishme që lehtëson të shprehurit, duke iu shmangur emërtimeve të stërholluara dy ose disafishe, të cilat për nga forma janë të papranueshme nga ligjërimi i së drejtës (p.sh.: “programi i Komisionit për mbrojtjen e ujit”, rreziku i preparateve për shëndetin etj.).
- Qëndrueshmëria, njëjtësia dhe njëtrajtësia në përdorimin e termave janë parakushte për t’iu shmangur ndryshimeve terminologjike, duke

respektuar gjithnjë formulimet më të përdorshme dhe më sintetike.

- Shmangia nga grumbullimi i tepërt i emrave të përveçëm, në mënyrë që të mos kufizohen më kot fushëveprimet e rregullave apo të ligjeve të hartuara.
- Ruajtja e strukturave gramatikore, semantike dhe stilistike të gjuhës shqipe, pa i zëvendësuar ato me kalke të kota nga gjuhët origjinale, pasi një gjë e tillë vështirëson të kuptuarit e ligjeve dhe kërkon interpretim të mëtejshëm të tyre.
- Mungesa e shprehësisë, që do të thotë se gjuha ligjore i përjashton shprehjet ekspresive apo arkaike.
- Ruajtja logjike e formave të njësive gjuhësore të përkthyer edhe për fjalët, edhe për frazat.

Sa i përket drejtshkrimit, është krejtësisht e natyrshme që përkthyesi duhet të mbështetet plotësisht në rregullat e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipes (1972) në të gjitha rastet kur ato nuk bien ndesh me dispozitat e caktuara të BE-së, si edhe në broshurat përkatëse, të cilat do të renditen më poshtë. Në raste të caktuara, për shembull, te shkrimi i emrave të huaj apo shkrimi i pozitave institucionale, mund të ndodhë që duhet të shmanget Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, pasi rregullat e përshkruara në të bien ndesh me dispozitat e caktuara të teksteve të BE-së.

1.2.3 Varësia nga forma e origjinalit

Përkthimi i rregullave të sakta duhet t'i përmbahet rregullimit formal të origjinalit, domethënë gërmat e mëdha dhe *italike*, vendosja e titujve dhe hapësirat midis rreshtave zbatohen sistematikisht dhe nuk respektohet vetëm formati dyshtyllor. Rregullimi formal i hollësishëm është përpunuar më poshtë në kapitullin e formatimit.

Gjithashtu, nuk lejohet të ndryshohet struktura origjinale bazë, paraqitja e tekstit, ndarja në kapituj, nene, etj. Në tekstet origjinale sipas dispozitave ES, shpeshherë shfaqen shprehje të gjata dhe pothuaj shpesh jotransparente. Shprehje të tilla duhen shmangur që të mos dëmtohet kuptueshmëria e tekstit dhe kjo mund të bëhet nëpërmjet përdorimit të shenjave përkatëse të pikësimit dhe rregullimit sintaksor të fjalive në përputhje me rendin logjik të shqipes. Në përkthimet e dispozitave ES, nuk lejohet që fjalitë të ndahen ose të bashkohen. Gjithashtu, në përdorimin e shenjave të pikësimit kërkohet që t'i përmbahemi pikësimit në origjinal, deri në atë shkallë që kjo konsekuencë nuk cenon rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe ose rregullat që përfshihen në këtë broshurë.

1.2.4 Kur lejohet shmangia nga origjinali?

Duhet të ndërhyhet me shumë kujdes në rregullimet që kanë të bëjnë me tërësinë e fjalive. Në ndryshimin e strukturës së fjalive, gjatë përkthimit në shqip nuk duhet të kalohet në atë nivel që përkthyesi të marrë vendime vetjake. Në shumicën e rasteve, teksti origjinal mjafton si orientues. Në raste të caktuara, është e pashmangshme të ndryshohet struktura e fjalisë që ajo t'i përgjigjet kërkesave të gramatikës dhe të stilistikës shqipe, duke mëtuar sendërtimin e një teksti të

rrjedhshëm e të kuptueshëm. Për ta arritur një gjë të tillë përkthyesi duhet t'i shmanget formës së përkthimit fjalë për fjalë, por ta bëjë përkthimin pasi ta ketë lexuar pjesën përkatëse (fjalinë, paragrafin) që synon ta përkthejë.

Në bazë të përvojës së tij profesionale dhe të njohurive, përkthyesi duhet të vendosë se në cilat raste është e domosdoshme shmangia nga origjinali dhe në ç'masë mund të kryhet kjo shmangie.

Thonjëzat fiksohen në të dyja skajet nga lart (ndryshe nga varianti i vjetër drejtshkrimor). Gjithashtu, data shkruhet e plotë, domethënë plotësohet data në trajtë dyvendëshe, duke shënuar edhe vendin (p.sh.: Prishtinë, më 07.02.2016). Në këtë pikë mund të ketë shmangie të pjesshme nga Drejtshkrimi i Shqipes, i cili sugjeron që data të shkruhet me numra njëshifrorë (p.sh., 7.2.2016).

Përkthyesit nga anglishtja duhet të kenë parasysh se sistemi ligjor anglosakson dhe terminologjia angleze në zonat e tjera shpesh ndryshojnë nga terminologjia ligjore kontinentale. Terminologjia angleze ka prirje për më shumë njëtrajtshmëri në krahasim me gjuhët e tjera dhe veçanërisht në përkthimet në gjuhën shqipe. Kjo ndodh si pasojë e dy sistemeve gramatikore e semantike të ndryshme. Shpeshherë shfaqen dhe shprehje që nga ana profesionale janë të parregullta ose edhe pështjelluese. Në raste të tilla është e domosdoshme t'u referohemi varianteve frënge ose gjermane apo edhe varianteve të tjera në gjuhët zyrtare të BE-së.

I.2.5 Rregullat e drejtshkrimit si dhe udhëzuesit e tjerë të gjuhës shqipe

Gjatë procesit të përkthimit të akteve ligjore të BE-së është e domosdoshme që përkthyesit t'i kenë gjithnjë parasysh dhe t'u përmbahen udhëzimeve të paraqitura në listën e botimeve të mëposhtme:

- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë. 1974.
- Fjalor i gjuhës shqipe (Fjalori i 54-tës). Ribotim anastatik. Botimet Çabej. Tiranë. 2005.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë. 2002.
- Zgjedhimi i foljeve në gjuhën shqipe. Zijadin Munishi. Libri Shkollor. Prishtinë. 1998.
- Fjalor i termave të së drejtës (shqip – frëngjisht – rusisht). Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë. 1986.
- Fjalor i terminologjisë juridike : anglisht – shqip, shqip – anglisht = Law dictionary : English-Albanian, Albanian-English. Shefije Hasani. Universiteti i Prishtinës. Fakulteti Juridik. Prishtinë. 1998.
- Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë 2004.
- Fjalor i biznesit, ekonomisë dhe financës, anglisht-shqip, shqip-anglisht = Dictionary of business, economics and finance, English-Albanian, Albanian-English. Nexhmi Rexha. ASAU. Prishtinë. 2009.
- Fjalorë të termave të ekonomisë.

- Fjalor i informatikës. Nebi Caka, Agni Dika, Seb Rodiqi. ASHAK. Prishtinë. 2005.

Përtej këtyre dokumenteve normative të shqipes, përthyesve u sugjerohet t'i konsultojnë edhe fjalorët shpjegues në gjuhën angleze, si dhe burimet e tjera të besueshme nga interneti.

I.2.6 Mjete të tjera ndihmëse në zyra

Baza e të dhënave e tekstit të plotë të Bashkimit Evropian Celex në CD-ROM (varianti anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht).

- Gazetë zyrtare për mikrofilma (varianti anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht).
- Drejtoria e Legjislacionit të Bashkimit Evropian në fuqi (botohet çdo 6 muaj me një vonesë më së shumti tremujore).

Udhëzuesit e përmendur të BE-së që duhet të shfrytëzohen:

- Fjalor juridik katër gjuhësh, E. Le Docte, CODEX, Pragë. 1997
- Udhëzuesi i akronimeve dhe shkurtimeve të përgjithshme e përdorur në Komunitetin Evropian, Turner, Keneth, Brown.
- Fjalor i terminologjisë që lidhet me Tregun e Brendshëm (marrë nga Libri i Bardhë)
- Fjalor shumëgjuhësh i shkurtimeve, Këshilli i Bashkimit Evropian, 1994.
- Fjalori i Komunitetit Evropian, Frëngjisht-Anglisht, Këshilli i Komunitetit Evropian, 1990.

II. LLOJI I DOKUMENTEVE

II.1 Rregulloret

1.	Council Regulation No 29	Rregullore e Këshillit nr. 29
2.	Commission Regulation No 64	Rregullore e Komisionit nr. 64
3.	Council Regulation No 219/66/EEC	Rregullore e Këshillit nr. 219/66/KEE
4.	Commission Regulation No 131/64/EEC	Rregullore e Komisionit nr.131/64 (KEE)
5.	Council Regulation (EEC) No 918/83	Rregullore e Këshillit nr. 918/83 (KEE)
6.	Commission Regulation (EEC) No 3020/77	Rregullore e Komisionit nr.3020/77 (KEE)
7.	Council Regulation (EC) No 314/2000	Rregullore e Këshillit nr. 314/2000 (KEE)
8.	Commission Regulation (EC) No 1250/1999	Rregullore e Komisionit nr.1250/1999 (KE)
9.	Council Regulation (ECSC, EC, Euratom) No 3163/94	Rregullore e Këshillit nr.3164/93 (KEQÇ, KE, Euratom)
10.	Commission Regulation (Euratom) No 3137/74	Rregullore e Komisionit nr. 3137/74 (Euratom)
11.	Regulation (EC) No 1783/1999 of the European Parliament and of the Council	Rregullore e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr.1783/1999 (KE)
12.	Regulation (EC) No 2818/98 of the European Central Bank	Rregullore e Bankës Qendrore Evropiane nr. 2818/98 (KE)
13.	Financial regulation	Rregullore financiare

II.2 Direktivat

1.	Council Directive	Direktivë e Këshillit
2.	Commission Directive	Direktivë e Komisionit
3.	Second Commission Directive	Direktivë e Dytë e Komisionit
4.	Council Directive 92/12/EEC	Direktivë e Këshillit 92/12/KEE
5.	Commission Directive 1994/81/EC	Direktivë e Komisionit 1994/81/KE
6.	Directive 98/34/EC of the European Parliament and of the Council	Direktiva 98/34/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit
7.	Council Directive 97/43/ Euratom	Direktivë e Këshillit 97/43/Euratom

II.3 Vendimet

1.	Decision No 22/66	Vendim nr. 22/66
2.	Commission decision No 2233/97/ECSC	Vendim i Komisionit nr. 2233/97/KEQÇ
3.	Decision No 818/95/EC of the European Parliament and of the Council	Vendim i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit nr. 818/95/KE
4.	Council Decision 1999/198/JHA	Vendim i Këshillit 1999/198/DPB
5.	Decision of the representatives of the Governments of the Member States, meeting within the Council (and of the Commission)	Vendim i përfaqësuesve të qeverive të shteteve anëtare (dhe i Komisionit), në mbledhjen e Këshillit
6.	Decision of the Council and of the representatives of the Governments of the Member States, meeting within the Council	Vendim i Këshillit dhe i përfaqësuesve të qeverive të shteteve anëtare në mbledhjen e Këshillit
7.	Decision of XXX	Vendim XXX

II.4 Rekomandimet

1.	High Authority Recommendation No 1/64	Rekomandimi i Autoritetit të Lartë nr. 1/64
2.	Commission Recommendation No 245/78/ECSC	Rekomandim i Komisionit nr. 245/78/KEQÇ
3.	Recommendation of XXX	Rekomandim i XXX

II.5 Akte të tjera

1.	Common Strategy 1999/66/CFSP of the European Council	Strategji e Përbashkët e Këshillit Evropian 1999/66/PPJS
2.	Joint Action 2000/6/CFSP of the Council	Veprim i Përbashkët i Këshillit 2000/6/PPJS
3.	Common Position 2000/45/CFSP of the Council	Qëndrim i Përbashkët i Këshillit 2000/45/PPJS
4.	Common Position 1999/302/JHA of the Council	Qëndrim i Përbashkët 1999/302/DPB i Këshillit
5.	Framework Decision 2000/105/JHA of the Council	Vendim Kuadër 2000/105/DPB i Këshillit
6.	Act	Akt

7.	action programme	program veprimi
8.	communication <i>nebo</i> notice	komunikatë ose njoftim
9.	interinstitutional agreement	marrëveshje ndërinstitutionale
10.	interpretative communication	komunikatë interpretuese
11.	Conclusions	Përfundime
12.	general programme	program i përgjithshëm
13.	Green Paper	dokument i Gjelbër
14.	guideline(s)	udhëzim(e)
15.	Initiative	Nismë
16.	Opinion	Opinion
17.	Pact	Pakt
18.	priority programme	program përparësie
19.	Report	Raport
20.	Final Report	raport përfundimtar
21.	Resolution	Rezolutë
22.	Statement	Deklaratë
23.	White Paper	dokument i Bardhë
24.	Declaration	Deklaratë
25.	Corrigendum	Korrigjim
26.	code of conduct	kodi i sjelljes
27.	Treaty	Traktat
28.	Convention	konventë
29.	Agreement	marrëveshje
30.	framework agreement	marrëveshje kuadër
31.	cooperation agreement	marrëveshje bashkëpunimi
32.	Europe agreement	Marrëveshja e Evropës
33.	interim agreement	marrëveshje e ndërmjetme
34.	(agreement in the form of an exchange of letters)	marrëveshje në formën e shkëmbimit të letrave
35.	Protocol	Protokoll
36.	additional protocol/ supplementary protocol	protokoll shtesë (protokoll plotësues)
37.	agreed minute	Procesverbali i Rënë Dakord
38.	memorandum of understanding	Memorandum Mirëkuptimi

III. DATA NË DOKUMENTE

of 24 May 1978	24 maj 1978
----------------	-------------

IV. LËNDA E DOKUMENTIT

Gjatë përkthimit të emërimit të dokumenteve është e nevojshme t'i shmangemi praktikës që në anglisht togjet emër + mbiemër, të cilët gramatikisht përkojnë në vlerë me rasën gjinore të shqipes, të përkthehen si grup i pandarë së bashku me mbiemrin, pasi në gjuhën shqipe mbiemrat e nyjshëm lakohen veçmas emrit që shoqërojnë. Duke lakuar në mënyrë të pandarë grupin, pra duke lakuar vetëm emrin, ata automatikisht shndërrohen në mbiemra të panyjshëm, gjë që e vështirëson kuptimin në shqip.

Për shembull: (Regulation) establishing the standard import values ...

Të shtjelluara mund të jenë (sipas rasteve konkrete):

fjalja e afërt me përemrat lidhorë “i/e cili/cila” dhe me foljen, për objekte të nënkuptuara, por të pashprehura në origjinal:

